

Statistikat e Pyjeve 2022

Tiranë më 07 Shtator 2023: Në vitin 2022, fondi pyjor dhe kulloror i Shqipërisë shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme prej 1.731.901 hektarë, duke përfaqësuar 60,2 % të sipërfaqes gjithsej të vendit.


Tab.1 Bilanci Kadastral i Fondit Pyjor dhe Kulloror të Shqipërisë

Viti	Pyje		Kullota		Sipërfaqe me bimësi pyjore dhe inproduktive		Total	
	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%
2020	1.051.841	60,4	478.081	27,5	210.382,1	12,1	1.740.304	100
2021	1.146.724	66,8	448.750	26,1	121.350,5	7,0	1.716.824	100
2022	1.146.725	66,2	449.175	25,9	136.002,0	7,9	1.731.901	100

Burimi i informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit /Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Në 2022, pyjet shtrihen në një sipërfaqe 1.146.725 hektarë, që përfaqëson 66,2 % të fondit pyjor dhe kulloror. Kullotat dhe livadhet zënë një sipërfaqe 449.175 hektarë ose 25,9 % të fondit pyjor dhe kulloror. Sipërfaqet me bimësi pyjore dhe jo-produktive që janë pjesë e fondit pyjor zenë një sipërfaqe 136.002 hektarë ose 7,9 % të këtij fondi.


Fig. 1 Sipërfaqja e Fondit Pyjor dhe Kulloror 2020 - 2022, (000 ha)



Për publikim 07/09/2023

Në vitin 2022, vëllimi i përgjithshëm i pyjeve, vlerësohet në rreth 54.063.000 m³, nga të cilat 94,0 % e këtij vëllimi përbëhet nga pyjet publike dhe 6,0 % nga pyjet private.

Fig. 2 Vëllimi i përgjithshëm i pyjeve, (000/m³)




Në vitin 2022, në fondin pyjor sipërfaqen më të madhe e zënë fletorët me 49,8 %, ndjekur nga të tjera lloje me 35,9 % dhe halorët 14,3 %.

Tab.2 Fondi pyjor sipas strukturës së llojeve, (ha)

Viti	Halorë	Fletorë	Shkurre	Pyje Gjithsej
2020	150.911	523.907	377.023	1.051.841
2021	164.524	571.166	411.034	1.146.724
2022	164.524	571.167	411.034	1.146.725

Burimi i informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit /Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Fig.3 Fondi pyjor sipas strukturës së llojeve 2022, (%)



Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë, janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ato ofrojnë.

Zonat e mbrojtura në vitin 2022, zenë një sipërfaqe të përgjithshme prej 608.684 hektarë, duke përfaqësuar 35,1 % të sipërfaqes së fondit pyjor dhe kulloror si dhe rreth 21,2 % të sipërfaqes së përgjithme të vendit. Gjatë vitit 2022, mbas procesit të rishikimit të kufijve dhe të vlerësimit të zonave të mbrojtura mjedisore, rrjeti i zonave të mbrojtura përcaktohet me 4 (katër) kategori nga 6 (gjashtë) që ishin në vitin 2021, ku si rezultat i këtij vlerësimi janë reflektuar ndryshime si në numrin ashtu dhe në sipërfaqen e tyre.

Tab. 2 Numri dhe sipërfaqja në hektarë e zonave të mbrojtura, 2020 - 2022


Kategoritë	Numri i zonave (Nr)			Sipërfaqja (Ha)		
	2020	2021	2022*	2020	2021	2022*
Rezervë Strikte Natyrore	2	2	0	4.800	4.800	0
Park Kombëtar	14	14	11	230.707	230.707	301.197
Monument Natyror	725	725	723	3.470	3.470	1.550
Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror	25	25	24	169.275	169.275	224.014
Peizazh i Mbrojtur	6	6	10	97.333	97.333	81.923
Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara	4	4	0	18.245	18.245	0
Gjithsej	776	776	768	523.831	523.831	608.684

Burimi i informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit /Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

*Në vitin 2022, rrjeti i zonave të mbrojtura përcaktohet me 4 (katër) kategori

Në vitin 2022, sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e zenë parqet kombëtare me 49,5 % të sipërfaqes gjithsej ndjekur nga rezervatet natyrore të menaxhuara me 36,8 %, pejsazhet e mbrojtura me 13,45 % dhe monumente natyrore 0,25 %.

Fig. 4 Struktura e sipërfaqes së zonave të mbrojtura sipas kategorive, (%)



Metodologjia

Të dhënat mbi statistikat e pyjeve dhe biodiversiteti mbështeten në të dhënat administrative me bazë vjetore. Institucioni përgjegjës për të grumbulluar këto të dhëna është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucione të tjera përgjegjëse në varësi të saj si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Pyjeve. Sipas Vkm Nr. 433, Datë 8.6.2016 për Transferimin në Pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, informacioni mblidhet në të gjitha Bashkitë e vendit të cilat kanë detyrimin ligjor të raportojnë cdo tre muaj në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave të pyjeve dhe biodiversitetit është “Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026”, duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.

Përkufizime

Kadastra e pyjeve: është një dokument zyrtar (regjistër), ku evidentohen, pasqyrohen, mbahen e përditësohen të dhënat fillestare për çdo njësi të ekonomisë pyjore apo për pellgjet ujëmbledhëse, të dhënat për ndryshimet periodike në vëllime, sipërfaqet dhe hartat përkatëse.

Fond pyjor: janë të gjitha sipërfaqet pyjore e jopyjore, burimet pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese, infrastruktura përkatëse, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura, të cilat krijojnë një mjedis harmonik me pyjet e tokën pyjore (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtet), brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe shkurret.

Zonat e Mbrojtura: mund të kenë forma të ndryshme si, park kombëtar, zona të paprekura, zona të ruajtura nga komuniteti, rezervate natyrore dhe rezervate private natyrore. Sipas IUCN, “Një zonë e mbrojtur është një hapësirë gjeografike e mirë përcaktuar, e njohur, e dedikuar dhe e menaxhuar përmes mënyrave ligjore ose metodave të tjera efektive, që sigurojnë mbrojtjen afatgjatë të natyrës dhe shërbimeve mjedisore të ekosistemeve që lidhen me të, si dhe vlerave kulturore.”